



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:009168

Datë: 25.11.2024

Numri i dokumentit: 06504745

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, në çështjen penale ndaj të pandehurit Q.S, me vendbanim në Rr. "B.O", nr.... në F..., duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND. 108/24, të datës 22.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit Q.S, në një të anë dhe të dëmtuarit F.H, në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 1793/23 e datës 12.01.2024, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndimi i lehtë trupor neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 25.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr.108/2024, e datës 22.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit Q.S, me vendbanim në Rr. "B.O", nr... në F..., i lindur me datë ..., me numër personal ..., në një të anë dhe të dëmtuarit F.H, në anën tjetër.
- II. Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1793/23 e datës 12.01.2024, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit Q.S, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndimi i lehtë trupor neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.1793/23, të datës 12.01.2024, i ka akuzuar të pandehurit Q.S, me vendbanim në Rr. “B.O” nr. .. në F... dhe të pandehurit L.Ll me vendbanim në Rr. “X.Ll” nr. .. në F..., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 KPRK-së.

Më datë 19.08.2024, është mbajtur shqyrtimi fillestar dhe në këtë shqyrtim bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Me aktvendimin e datës 21.08.2024, gjykata ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurit L.Ll, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Më datë 22.08.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. 108/2024, në mes të pandehurit Q.S, me vendbanim në Rr. “B.O”, nr. .. në F..., i lindur me datë ..., me numër personal ..., në një të anë dhe të dëmtuarit F.H, në anën tjetër.

Më datë 19.11.2024, kjo marrëveshje është sjellë nga zyra e Ndërmjetësimit në zyrën e gjyqtarit.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv. Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2024:021200, datë 25.11.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.